Kombetarja/ Lacio, midis tre ekipeve qe kerkojne Abrashin,

nga AlbaniaSoccer
E martë, 24 Shtator 2013 04:49

Mesfushori i kombetares se Shqiperise Amir Abrashi eshte ndjekur me vemendje nga disa klube ne Evrope dhe ne muajin Janar pritet nje konkurence e forte midis Bajern Leverkusen, SS Lacio e FC Basel te cilat pretendojne te ofrojne sherbimet e mesfushorit Shqiptar.

23-Vjecari Abrashi qe luan me Grasshoppers ne kampionatin Zviceran, ka shume mundesi qe te ndryshoj klub ne afatin kalimtar dimeror. Pervec klubit rival Zviceran te Basel, per mesfushorin e kombetares Kuq e zi jane interesuar edhe Leverkusen me Lacion.